



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 13, datë 20.06.2018

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“NDËRTIMI I BURIMIT TË RI GJENERUES TË ENER GjISË, HIDROCENTRALIT
“THIRRE”, NË PËRROIN E THIRRËS DHE NË DEGËT FORMUESE TË TIJ, AI I
KUMBULLËS, RUNJËS DHE QARRIT, DEGË E LUMIT FAN I VOGËL, BASHKIA
MIRDITË, QARKU LEZHË”

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë “Sang 1” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Ndërtimi i burimit të ri gjenerues të energjisë, Hidrocentralit “Thirre”, në përroin e Thirrës dhe në degët formuese të tij, ai i Kumbullës, Runjës dhe Qarrit, degë e lumit Fan i Vogël, Bashkia Mirditë, Qarku Lezhë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Sang 1” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) miratimit të procedurave për heqjen nga fondi pyjor/kullosor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Mirditë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DAMIAN GJIKNURI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

